

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L

Për: UNIVERSITETI I PRISHTINËS

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Nr¹ i prokurimit

242-26-1989-5-1-1

Titulli: **“Renovimi i Fakultetit të Bujqësisë dhe Veterinës”**

AKTIV SH.P.K.

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rr. Don Shjefen Kurti

(Adresa)

PRISHTINË

(Vendi)

10000

(Kodi postar)

044175147

(Numri Telefonit)

N/A

(Numri i Faks-it)

Ekrem Elshani

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

Aktivgroup.ks@gmail.com

(Adresa elektronike)

03.07.2026

(Data e parashtrimit të kërkesës)



(Nënshkrimi dhe vula)

2. Identifikimi i avokatit

*Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtroj kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me **PROKURË**.*

¹ Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të kërkesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

| |
|---|
| Njoftimi për kontratë: 29.04.2026 Procesverbali i hapjes: 25.05.2026 Njoftimi mbi vendimin e AK: 18.06.2026 Kërkesa për qasje në dokumentacion: 18.06.2026, Qasja e ofruar: 19.06.2026 Kerkese për rishqyrtim: 23.06.2026 Refuzimi i kërkesës për rishqyrtim: 24.06.2026 Ankesa në OSHP: 03.07.2026 |
|---|

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

Jo

Procesverbalin e hapjes e kemi pranuar përmes sistemit të E-prokurimit.

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

Jo

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 – Qëllimi: Ky nen përcakton qëllimin e ligjit, i cili është të rregullojë procedurat për prokurimin publik në mënyrë të drejtë, transparente dhe konkurruese.

Neni 6 – Ekonomiciteti dhe Efikasiteti: Autoriteti kontraktues është i obliguar të sigurojë përdorim sa më efikas dhe ekonomik të fondeve publike gjatë procesit të prokurimit.

Neni 7 – Barazia në trajtim / Jo-diskriminimi: Të gjithë operatorët ekonomikë duhet të trajtohen në mënyrë të barabartë dhe të drejtë, pa diskriminim në asnjë fazë të procedurës së prokurimit.

Neni 59 – Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve: Përcakton rregullat dhe kriteret për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave të dorëzuara nga operatorët ekonomikë.

Neni 69 – Aftësia teknike dhe/ose profesionale: Kërkesat për dëshmimin e aftësive teknike dhe profesionale që duhet të përmbushin operatorët ekonomikë për të qenë të kualifikuar për kontratën përkatëse.

Neni 72 – Dokumentacioni dhe informacioni shtese: Autoriteti Kontraktues ka pasur baze ligjore për të kërkuar dokumentacione shtese. Mungesa e kësaj kerkese për sqarim përben shkelje të drejtpërdrejt të këtij neni

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.

AK/Komisioni vleresues gjate vleresimit te ofertave per projektin ne fjale nuk ka vepruar ne harmoni me LPP Nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotesuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr.05/L-092 perkatesisht dispozitat ligjore te lartecekura dhe Rregulloren e Udhezimin operativ per prokurim publik.

Me date 18.06.2026 permes platformes elektronike e-prokurimi jemi njoftuar se ne AKTIV SH.P.K. jemi eliminuar edhe pse kemi qene te pergjegjshem me cmimin me te lire, duke e rekomanduar per kontrate OE 2A Group SH.P.K., me cmim me te larte.

Veprimet e AK-se jo vetem qe jane te kunderligjshme, por edhe tregojne qarte nje qellim diskriminues ndaj kompanise tone, duke cenuar parimet themelore te barazise dhe konkurrences se ndershme ne prokurimin publik.

Ne emer te AKTIV SH.P.K, ne cilesine e pjesemarresit ne proceduren e prokurimit parashtrojme kete ankese:

Gjate qasjes ne dokumente Zyrtari Pergjegjes i Prokurimit te AK- Universiteti i Prishtines, na ka mundësuar qasje te kufizuar vetem ne 4 foldera përmes te cilëve nuk ishe i mundur vlerësimi i plote te ofertës.

-Dokumentet e ofruara nga AK janë: Dokumentet e biznesit, Deklarata nen betim, Iso Standardet, Sigurimi i tenderit, dhe lista e cmimeve

-Ne qasje nuk janë ofruar; Gjendja ekonomike financiare- folderi 3

Lista e referencave- folderi 5

Personeli- folderet 6.1 dhe 6.2

Raporti i vlerësimit te rriskut- folderi 7.1

Marreveshjet per trajnime- folderi 7.2

Pajisjet/ marrëveshjet- folderet 8.1 dhe 8.2

Plani dinamik – folderi 9

Pra, dokumentet që NUK janë dhënë janë pikërisht dokumentet mbi bazën e të cilave AKTIV SH.P.K. është eliminuar. Pa to, NE nuk mund të verifikojmë nëse OE i rekomanduar i ka përmbushur të njëjtat kërkesa dhe nëse AK ka zbatuar standard të barabartë vlerësimi.

Neni 7.1 i LPP-së kërkon që AK t'i trajtojë operatorët ekonomikë në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe të veprojë në mënyrë transparente. **Neni 7.2** ndalon çdo veprim që redukton konkurrencën ose favorizon apo diskriminon një ose më shumë operatorë.

Pretendimet e AK-s ndaj ofertës se AKTIV SH.P.K. se nuk plotësohen kushtet; për referencat, stafin, riskun, pajisjet dhe planin dinamik, ndërkohë AK nuk na ka mundësuar qasje ne dokumentacionin ekuivalent të OE të rekomanduar per kontrate, duke pamundesuar qe dokumentacioni i OE ti nënshtrohet kontrollit të palës së interesuar, e bën procesin të paverifikueshëm dhe cenon transparencën dhe barazinë në trajtim dhe shkel ligjin e LPP-se

Neni 10.3 i LPP-së obligon AK-në që, me kërkesë me shkrim të palës së interesuar, të sigurojë qasje të arsyeshme në dokumentacionin e aktivitetit, përveç informatave që vërtetohen ligjërisht si sekrete afariste. **Neni 10.4** kërkon që qasja të sigurohet në mënyrë të rregullt, të qetë dhe pa pengesa, ndërsa **neni 10.5** kërkon dhënien e kopjeve të materialit në të cilin pala ka të drejtë qasjeje.

Neni 7.4 i Rregullores Nr. 001/2022, versioni i konsoliduar, kërkon qasje të shpejtë dhe të arsyeshme në të gjitha të dhënat që nuk janë klasifikuar ligjërisht si sekret. **Neni 7.6.3** kërkon qasje të menjëhershme në versionin e pastruar dhe mbajtjen e procesverbalit të nënshkruar nga palët.

Në rastin konkret nuk janë dhënë as dokumentet, as versionet e tyre të pastruara dhe as përmbledhjet e përgjithshme. Pretendimi i AK-së në email se është ofruar “versioni i pastruar” nuk përputhet me përmbajtjen faktike të materialit të dorëzuar.

Neni 11.3 i LPP-së lejon klasifikimin vetëm nëse plotësohen kushtet ligjore, përfshirë paraqitjen e arsyeve që bindshëm demonstronjë se qasja publike në elementin konkret do të shkaktonte dëm material të interesave legjitime komerciale.

Neni 7.6(b) i Rregullores kërkon arsyetim për *secilin dokument* të identifikuar si sekret. **Neni 7.6.1** ndalon AK-në të pranojë klasifikimin nëse Aneksi 3 nuk përmban të gjitha faktet dhe argumentet që dëshmojnë dëmin material. **Neni 7.6.5** përcakton shprehimisht se jo të gjitha dokumentet e neneve 68 dhe 69 mund të klasifikohen si sekret dhe se dokumentet publike sipas ligjit nuk mund të fshehen.

Aneksi 3 i 2A Group përdor formulim të përgjithshëm për të gjitha informatat e neneve 68 dhe 69, pa listuar dhe pa arsyetuar veçmas secilin dokument. Një klasifikim i përgjithshëm i tërë referencave, stafit, pajisjeve, riskut dhe planit dinamik nuk e përmbush kërkesën për individualizim dhe arsyetim konkret.

Edhe nëse disa elemente do të përmbushnin kriteret e sekretit, **neni 11.4 i LPP-së** obligon AK-në të përgatisë version të pastruar të çdo dokumenti që përmban edhe informata jo-sekrete. Kur dokumenti përmban vetëm informata të klasifikuara, **neni 11.5** kërkon një përmbledhje të përgjithshme jo-sekrete. **Neni 7.6.2 i Rregullores** kërkon që versionin e pastruar të përgatitet para publikimit të B58. Këto detyrime nuk janë përmbushur.

Sqarimi i tenderit- **Neni 59.2 i LPP-së** lejon AK-në të kërkojë sqarim me shkrim për çdo aspekt të tenderit, me kusht që të mos lejohet ndryshim material. **Neni 59.4** lejon që një tender të konsiderohet i përgjegjshëm kur përmban vetëm gabime ose paqartësi që mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material, ose devijime të vogla pa efekt material.

Neni 38.3 i Rregullores lejon kërkimin dhe pranimin e informatave ose dokumenteve që mungojnë, kur ato objektivisht paraqesin prova të mjaftueshme që pasqyrojnë gjendjen ekzistuese para skadimit të afatit të tenderimit. **Neni 38.4** kërkon kushte të njëjta për të gjithë

OE-të dhe kërkimin e informatave për qartësimin e deklaratave ose certifikatave të paqarta; vlefshmëria e ofertës mund të vendoset vetëm pas përgjigjes dhe shqyrtimit të dokumenteve shtesë. **Neni 38.5** lejon plotësimin ose qartësimin e dokumenteve sipas neneve 65-71 të LPP-së, ndërsa **neni 38.6** kërkon afat jo më të shkurtër se pesë ditë.

Kërkesa jone nuk është që të ndryshohet çmimi, stafi, pajisjet, kontratat apo përmbajtja materiale e ofertës pas afatit. Kërkohet vetëm sqarimi ose dokumentimi i fakteve që kanë ekzistuar para afatit, brenda kufijve të nenit 38.2 dhe 38.3.

Nga dokumentacioni që patem qasje, Ne vërejmë se **OE i rekomanduar për kontratë ka paraqitur vërtetim tatimor me obligime të papaguara.**

Sipas nenit 65 të Ligjit për Prokurimin Publik, në raste të tilla kërkohet që operatori të dëshmojë marrëveshje të vlefshme me ATK për shlyerjen e borxhit para dates së publikimit të te njoftimit për kontratë dhe respektimin e saj.

Ne nuk kemi pasur qasje nëse marrëveshja është dorëzuar dhe vlerësuar nga Autoriteti Kontraktues si pjesë e dosjes së ofertës, për shkak të kufizimit të lartcekura.

Megjithatë, ne do të argumentojmë në mënyrë të detajuar se konstatimi i AK-se për eliminimin tonë është i pabazuar dhe në kundërshtim me LPP-ne dhe Rregulloret në fuqi

Pretendimi 1.

Pretendimi i AK- se **AKTIV SH.P.K.** nuk ka kontratë të ngjashme në vlerë minimale prej 1,000,000.00 € është i pabazuar dhe në kundërshtim me dokumentacionin e dorëzuar në ofertë.

OE **AKTIV SH.P.K.** ka paraqitur referenca dhe kontratë të realizuara në vlera shumë më të larta se minimumi i kërkuar nga Autoriteti Kontraktues, duke dëshmuar kapacitetin teknik dhe profesional për realizimin e kontratës

Ndër të tjera është paraqitur kontratë me Islamic Relief me titull "Ndërtimi i shtëpive për familjet në nevojë, rindërtimi i shtëpive dhe meremetimet", në vlerë prej rreth 1,200,000.00 €, e cila përfshin drejtpërdrejt punime të rindërtimit dhe meremetimit të objekteve.

Po ashtu janë paraqitur kontratë për ndërtimin e objekteve banesore, punime ndërtimore në ndërtesa, punë ndërtimore për ndërtimin e shtëpive me organizata ndërkombetare, të cilat për nga natyra, kompleksiteti i tyre është me i lartë.

Shih me poshte kontratat e perfunduara, ku jane edhe te bashkangjitura ne aneksin 6 te listes se kontratave, 6.7 milionEuro vlera e kontratave me natyre ndertimore, renovuese jane te perfunduara. **Kontratat tona i tejkalojne kerkesat e AK.**

| <u>Kontrata e përfunduar</u> | <u>Data e përfundimit</u> | <u>Vlera (EUR)</u> |
|--|---------------------------|---------------------|
| <u>Ndërtimi i shtëpive për familjet në nevojë. rindërtime dhe meremetime</u> | 05.02.2024 | 1,270,000.00 |
| <u>Ndërtimi i objektit afarist-banesor B+P+10+PH</u> | 10.07.2025 | 2,724,327.16 |
| <u>Ndërtimi dhe furnizimi me material në rezidencën Capital Hill</u> | 06.05.2024 | 1,642,016.00 |
| <u>Ndërtimi i 32 shtëpive - IOM</u> | 11/2025 | 994,189.03 |
| <u>Ndërtimi i shtigjeve të ciklizmit</u> | 03.02.2025 | 28,477.00 |
| <u>Realizimi i punëve ndërtimore në NS Prishtina 3 - KOSTT</u> | 20.05.2025 | 78,557.32 |
| <u>Gjithsej</u> | | 6,737,566.51 |

Pretendimi 2.

Pretendimi i AK se inxhinierat e paraqitur nga ne nuk permbushin kerkesat e dosjes se tenderit eshte i pasakte.

Per z. Artan Dashin jane dorezuar diploma, CV-ja, kontrata e punes dhe referenca e leshuar nga punedhenesi AC ing SH.P.K.

Nga CV-ja rezulton pervoje profesionale ne MULTISYSTEM, N.P.SH. Muja, AI Trade dhe AC ing, ndersa referenca e AC ing deshmon angazhimin e tij profesional qe nga marsi 2017 dhe perfshirjen ne projekte te shumta ndertimi dhe renovimi deri ne vitin 2023.

Bazuar ne dokumentacionin e dorezuar, z. Artan Dashi deshmon qarte mbi 5 vite pervoje profesionale ne fushen e kerkuar, prandaj konstatimi i Autoritetit Kontraktues eshte ne kundërshtim me provat e paraqitura ne oferte.

Per z. Hamdi Qorri jane dorezuar CV-ja, diploma, Licenca A(e cila verteton edhe pervojen), kontrata e punes dhe kater referenca profesionale. Nga dokumentacioni i dorezuar rezulton se ai ka pervoje shumevjecare (mbi 40 vjet eksperience)ne fushen e arkitektures, projektimit dhe mbikeqyrjes se projekteve.

Prandaj, dokumentacioni i dorezuar deshmon qarte se z. Hamdi Qorri ploteson dhe tejkalon kriterin minimal prej 5 viteve pervoje te kerkuar ne Dosjen e Tenderit.

Pretendimi 3.

Lidhur me pretendimin se mungon Raporti i Vlerësimit të Riskut, theksojmë se në ofertë është dorëzuar vërtetim i noterizuar i lëshuar nga subjekti i licencuar, i cili dëshmon se vlerësimi i riskut është kryer dhe se raporti ekziston.

Vërtetimi i dorëzuar nuk përmban vetëm konstatim të përgjithshëm, por identifikon edhe pozitat e punës për të cilat është kryer vlerësimi i riskut, duke përfshirë rreth 30 pozita të ndryshme pune. Dokumenti i dorëzuar paraqet dëshmi konkrete se procesi i vlerësimit është realizuar dhe dokumentuar.

Duke qenë se raporti i plotë përmban volum te madh te faqeve, është dorëzuar vërtetimi i noterizuar si dëshmi zyrtare e ekzistimit të tij. Nëse Autoriteti Kontraktues ka pasur nevojë për verifikim shtesë, raporti i plotë ka qenë i disponueshëm dhe mund të paraqitet menjëherë, pa ndikuar në përmbajtjen e ofertës apo në trajtimin e barabartë të operatorëve ekonomikë.

Pretendimi 4.

Pretendimi se mungojnë dëshmitë për dy kamionët kiper, damperin dhe lugën ngarkuese eshte i pasakte. Arkivi “6. Lista e pajisjeve” përmban dy dokumente të veçanta për kiperët, përfshirë dokumentet e regjistrimit. Arkivi “6.1 Lista e pajisjeve” përmban marrëveshjen për damperin dhe marrëveshjen për lugën ngarkuese.

Marrëveshjet për damperin dhe lugën janë lidhur më 22.05.2026, para afatit të ofertimit, e identifikojnë saktë tenderin me nr. 242-26-1989-5-1-1 dhe Universitetin e Prishtinës, dhe vlejnjë deri në përfundimin e kontratës. Dosjet përmbajnë edhe dokumente mbështetëse për pajisjet. AK duhet t'i rivlerësojë dokumentet e ngarkuara. Nëse ndonjë faqe, regjistrim ose karakteristikë teknike ishte e paqartë, duhej të kërkohej sqarim sipas **nenit 38.3-38.5**, jo të konstatohej mungesë e përgjithshme.

Pretendimi 5.

Plani dinamik i ngarkuar është dokument njëfaqësh i nënshkruar dhe vulosur, që përmban 27 pozicione sipas disiplinave të paramasës, datën e fillimit dhe përfundimit për secilin pozicion, numrin e ditëve, shtrirjen ditore të punëve, ditët e diel si pushim dhe tri rreshta për numrin e punëtorëve, numrin e stafit teknik dhe totalin sipas datave. Dokumenti përmban edhe shënimin se gjatë periudhës 15.06.2026-31.10.2026 nuk ka festa zyrtare dhe se të dielat janë shënuar në plan.

-Vendimi i AK nuk thotë se plani mungon; ai e quan planin e paraqitur “jo të qartë”, pa treguar se cili nga elementet e mësipërme mungon ose është i paqartë. Nëse AK ka konsideruar se 27 pozicionet duhej të zbrërtheheshin më tej në secilin nënpozicion të paramasës, këtë duhej ta identifikonte konkretisht dhe të kërkonte sqarim me B47. Ky është rast i drejtpërdrejtë i **nenit 38.4**, i cili kërkon qartësimin e dokumenteve/deklaratave të paqarta para vendimit mbi vlefshmërinë.

Perfundim:

OE AKTIV SH.P.K. nuk ka pasur qasje në dokumentacionin kryesor të OE të rekomanduar për kontratë, pasi pjesët kryesore të dokumentacionit janë klasifikuar si sekret afarist, dhe nuk na është dhënë versioni i pastruar i tyre.

Nuk kemi pasur mundësi të verifikojmë referencat, stafin profesional, pajisjet, kapacitetet teknike dhe dokumentacionin tjetër relevant mbi bazën e të cilit është vlerësuar përmbushja e kriterëve të Dosjes së Tenderit.

Duke pasur parasysh se eliminimi i OE AKTIV SH.P.K. është mbështetur pikërisht në pretendime që lidhen me referencat, stafin profesional, pajisjet dhe dokumentacionin teknik, ndërsa të njëjtat kategori dokumentesh të OE i rekomanduar për kontratë nuk kanë qenë të qasshme për verifikim, mbetet e pamundur të vlerësohet nëse të njëjtat standarde dhe kriterë janë zbatuar në mënyrë të barabartë ndaj të gjithë operatorëve ekonomikë.

Nëse AK do të kishte pasur paqartësi lidhur me ndonjërin nga dokumentet e dorëzuara nga OE AKTIV SH.P.K., të njëjtat kanë mundur të sqarohen dhe verifikohen në përputhje me nenin 72 të Ligjit për Prokurimin Publik, pasi bëhet fjalë për dokumente dhe dëshmi që kanë ekzistuar para afatit për dorëzimin e ofertave dhe që mund të verifikohen. Në vend të një vlerësimi të tillë, AK ka zgjedhur eliminimin e ofertës sonë me të lire pavarësisht faktit se dokumentacioni i dorëzuar përmbushjen e kërkesave të Dosjes së Tenderit.

AK nuk e ka respektuar nenin 7 të LPP-së, duke rekomanduar për kontratë **OE me çmim me të larte**. Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që “Autoriteti kontraktues do të trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente. Po ashtu paragrafi 6 i nenit 7 të LPP-së e parasheh që Gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; që (vi) që tenderi i

zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtjesore të kushteve, kritereve dhe specifikimeve përkatëse, mirëpo ju nuk i jeni përmbajtur as kësaj dispozite ligjore.

Po ashtu nuk e ka respektuar edhe nenin 6 të LPP-së edhe pse autoritetet kontraktuese janë të obliguar që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së.

Autoriteti Kontraktues duhet të kete në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

EKZISTON NJE FAKT I PATJETERSUESHM QE JEMI NE PERPUTHJE TE PLOTE ME KERKESAT E PERCAKTUARA NE NJOFTIMIN PER KONTRATE DHE DOSJEN E TENDERIT.

Duke u bazuar ne faktet e patjetërsueshme te kjarata dhe te dokumentuara, kërkujmë nga AK qe te mos vazhdojne me vendimin e shpallur, pasi ne kete menyre do te shkelni ligjin e LPP-ne Duke dëmtuar rende bugjetin e shtetit, dhe duke rrezikuar ngritjen e procedurave penale ndaj shkeljeve te mundshme.

Në fund kërkujmë nga ju si OSHP që të nxjerrni

VENDIM

- I. APROVOHET**, e bazuar ankesa e OE AKTIV SH.P.K
- II. OBLIGOHET** Autoriteti Kontraktues- Universiteti i Prishtines qe te ktheje lenden ne ri-vleresim dhe me rastin e ri-vleresimit te ofertave te rekomandohemi per kontrate ne si Operator Ekonomik i përgjegjshëm me çmimin me te lire.

Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi të detyruar të vazhdojmë procedurën ligjore në institucionet tjera kompetente.

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

- Kostot e përgatitjes së ofertës dhe dokumentacionin përcjellës,
- Dëmin ekonomik të shkaktuar nga humbja e një kontrate të mundëshme,
- Pengesën në realizimin e investimeve të planifikuara për këtë aktivitet

9. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës së tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mospara-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet.*